



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

**NJOFTIM PËR SHPREHJE INTERESI PËR POZICIONIN 1 (NJË) INSPEKTOR I
LARTË PËR KONTROLLIN E SIGURIMIT TË CILËSISË
PRANË BORDIT TË MBIKËQYRJES PUBLIKE**

Bordi i Mbikëqyrjes Publike në zbatim të kërkesave të ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 786 datë 09.11.2016 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve si dhe rregullat e organizimit e të funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”, i ndryshuar, shpall procedurat për pozicionin:

1 Inspektor i Lartë për Kontrollin e Sigurimit të Cilësisë pranë BMP, me kategorinë e pagës II-b.

I. Përshkrimi i përgjithshëm lidhur me pozicionin

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- Zbaton procedurat e kryerjes së kontrollit të sigurimit të cilësisë në mënyrë të pavarur, objektive, me profesionalizëm dhe udhëhiqen nga interesi publik dhe zbatimi i ligjit, manualeve, udhëzimeve dhe standardeve të pranuara ndërkombëtarisht për të siguruar cilësinë e auditimeve;
- Përgatit programin dhe procedurat, dhe planin vjetor të kontrollit për sigurimin e cilësisë;
- Dokumenton procesin e kontrollit të sigurimit të cilësisë dhe identifikon shkelje, mangësi apo praktikat e papajtueshme të audituesit ligjor ose shoqërisë audituese subjekt kontrolli dhe propozon masat përkatëse në përputhje me ligjin për auditimin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- Mbikëqyr pajtueshmërinë me ligjin për auditimin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, të veprimtarisë së organizatës profesionale të audituesve ligjorë dhe komiteteve, komisioneve të ngritura pranë saj;
- Mbikëqyr pajtueshmërinë ligjore të veprimtarisë së organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar, të njohura nga BMP.

II. Kriteret e përgjithshme

Kandidati duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- a. Të jetë shtetas shqiptar me banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë;
- b. Të ketë zotësi për të vepruar;
- c. Të ketë përfunduar studimet universitare të ciklit të dytë ose të zotërojë diplomë universitare të ekuivalentuar me këtë nivel në profilet auditim, kontabilitet ose financë, si dhe të kenë jo më pak se 7 (shtatë) vjet përvojë pune në fushën e auditimit ligjor e të raportimit financiar dhe në raportimin e qëndrueshmërisë, si dhe dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë apo shërbime të tjera të lidhura të qëndrueshmërisë,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

kombinuar me trajnime specifike për dhënien e sigurisë së cilësisë, kur kjo e fundit është e zbatueshme;

- d. Të mos ushtrojë profesionin e audituesit ligjor dhe të mos jetë i punësuar apo i angazhuar me një auditues ligjor ose shoqëri auditimi;
- e. Të mos jenë marrë ndaj tij/saj masa disiplinore të largimit nga puna për shkak të një shkelje të rëndë disiplinore gjatë dy viteve të fundit, kur kjo dispozitë është e aplikueshme;
- f. Të mos jetë i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë;
- g. Të zotërojë gjuhën angleze në nivel të pranueshëm dhe të përshtatshëm për punën;
- h. Të mos jetë i përfshirë në qeverisjen ose të punësuar apo të kontraktuar në organizata të tjera profesionale, por mund të jetë anëtar i këtyre organizatave.

III. Dokumentacioni i kërkuar për aplikim

- Letër motivimi;
- Jetëshkrim (CV) i përditësuar;
- Kopje të dokumenti të identifikimit (kartë ID ose pasaportë);
- Kopje të diplomës universitare të ciklit të dytë “Master” ose ekuivalente, si dhe diplomave të tjera të arsimit të lartë (nëse ka), gradat shkencore/ titujt akademikë;
- Dokumentacion që vërteton përvojën profesionale;
- Dëshmi penaliteti;
- Dokumente mbështetëse për kualifikime, specializime, trajnime profesionale (nëse disponohen);
- Çdo dokument tjetër që kandidati vlerëson se mbështet aplikimin dhe plotësimin e kriterëve të përcaktuara.

IV. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Data e hapjes së aplikimeve: **21.05.2026**
- Afati i fundit për aplikim: **21.06.2026**

Personat e interesuar duhet të paraqesin dokumentacionin e mësipërm nëpërmjet postës elektronike në adresën: info@bmp.al.

V. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Vlerësimi i kandidatëve do të kryhet nga një komision i posaçëm, bazuar në metodologjinë e vlerësimit të miratuar nga BMP, sipas sistemit si më poshtë:

Në fazën e parë do të kryhet verifikimi paraprak i kandidatëve, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen e njoftuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë BMP. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Në fazën e dytë, kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara do të kontaktohen nëpërmjet postës elektronike për fazën e mëtejshme të procesit të përzgjedhjes, e cila përfshin intervistën e strukturuar me gojë. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës (15 pikë);
- Eksperiencën e tyre të mëparshme (15 pikë);
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën (10 pikë).

VI. Njoftimi i rezultateve për secilën fazë të konkurrimit

Njoftimi i rezultateve për fazën e verifikimit paraprak

Në datën 29.06.2026 BMP do të shpallë në faqen zyrtare të internetit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për fazën paraprake, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista për fazën e dytë.

Në të njëjtën datë, kandidatët që nuk plotësojnë kushtet dhe kërkesat do të njoftohen individualisht nga BMP për shkaqet e mos kualifikimit (nëpërmjet adresës elektronike).

Njoftimi i rezultateve për fazën përfundimtare

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, BMP do të shpallë fituesin në faqen zyrtare të tij pas përfundimit të fazës së ankimit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht nëpërmjet adresës elektronike nga BMP, për rezultatet e vlerësimit.

VII. Ankimi

Kandidati, ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim pranë BMP, për rezultatin e pikëve dhe/ose renditjen në listën fituese. Afati i ankimit fillon brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual të rezultatit të vlerësimit. Të gjithë ankuesit marrin përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit ankimor të përcaktuar në këtë pikë.

Duke ju falënderuar,

Bordi i Mbikëqyrjes Publike